

NJOFTIM

APLIKIMI PËR PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2016

Aplikimi për provimet e Maturës Shtetërore me formularët A1/A1Z, fillon në Portalin Qeveritar e-albania dhe përfundon në portalin e Maturës Shtetërore online.

Aplikimi në Portalin Qeveritar e-albania duhet të kryhet në periudhën 21mars -10 prill 2016.

Aplikimi në Portalin Matura Shtetërore 2016, do të kryhet në periudhën 25 mars-10 prill 2016, sipas kalendarit të publikuar nga AKP.

Formulari A1 plotësohet online vetëm nga maturantët e vitit shkollor 2015-2016.

Aplikimi online me **Formularin A1** bëhet në shkollën ku maturanti vazhdon mësimin. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet “mbikëqyrës”.

Formulari A1Z plotësohet online vetëm nga kandidati, i cili është individi që ka mbaruar Maturën Shtetërore përpara vitit 2016 dhe ka detyrim për të dhënë provimet e Maturës Shtetërore.

Plotësimi online i **Formularit A1Z**, për kandidatët bëhet në shkollat ku kanë kryer arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja e vendbanimit, nëse shkolla e mesme që kanë përfunduar është mbyllur. Ata duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesën me shkrim për dhënien e provimeve të Maturës;
2. Kopje të noterizuar e Dëftesës së Pjekurisë/Vërtetimin me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, me fotografi, lëshuar nga drejtori i shkollës, sipas regjistrit të amzës apo dokumentit të lëshuar nga arkivi i shtetit dhe legalizuar nga titullari i DAR/ZA-së. Në bazë të dokumenteve të paraqitura, KMSH-ja përcakton notën mesatare të viteve të shkollimit, si edhe notat e provimeve të detyruara D1 e D2, të cilat ia përcjell zyrtarisht shkollës ku kandidatët do të regjistrohen për në Maturën Shtetërore.
3. Vërtetimin e notave të provimeve të Maturës Shtetërore lëshuar zyrtarisht nga DAR/ZA-ja. Ky vërtetim i bashkëngjitet formularit të aplikimit A1Z dhe ruhet në shkollë.

Procesi i plotësimit të **Formularit A1Z** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet “mbikëqyrës”.